



# KOMUNA JONË FUT TAKSËN PËR QESE

1 janar 2013

Në bazë të legjislacionit federal dhe kantonal dhe të rregullores së re komunale mbi administrimin e mbeturinave, kostoja e eliminimit të mbeturinave do jetë në ngarkim të atyre që i krijojnë.

## PËR JU, KJO DO TË THOTË QË:

- **Prej 1 janarit** do të lejohen të përdoren për mbeturinat shtëpiake vetëm **qeset e bardha dhe jeshile që u nënshtrohen taksave zyrtare.**
- Qeset e zakonshme (gri, të zeza apo transparente) do të jenë të ndaluara.
- Ndaj atyre që shkelin rregullat do të ndërmerren ndëshkime.

Ju mund t'i blini këto qese në dyqanet e zakonshme që prej 10 dhjetorit me çmimet e mëposhtme:

17 litra	•	rul prej 10 qesesh	•	Fr. 10.-
35 litra	•	rul prej 10 qesesh	•	Fr. 20.-
60 litra	•	rul prej 10 qesesh	•	Fr. 38.-
110 litra	•	rul prej 5 qesesh	•	Fr. 30.-

**TË NDASH MBETURINAT  
do të thotë...  
TË VLERËSOSH**

Për çdo lloj informacioni, lutemi t'i drejtoheni administratës komunale ose të telefononi në numrin 0800 804 806 (numër pa pagesë)

[www.vaud-taxeausac.ch](http://www.vaud-taxeausac.ch)



## NJË QESE E TAKSUAR ËSHTË NJË TAKSË SHITESË. PËRSE?

Komuna jonë ka vendosur të zbatojë parimin që ai që ndot paguan : ai që prodhon mbeturina paguan eliminimin e tyre.

Qeset e mbeturinave së shpejti do të ndërrojnë ngjyrën. Këto qese, **përdorimi i të cilave është i detyrueshëm**, do të jenë të njëjta në të gjithë krahinën. Ato do mund të blihen në dyqane të ndryshme si dhe në Postë.

Megjithatë, çmimi i qeses nuk i mbulon të gjitha kostot. Një taksë shtesë do të mundësojë financimin e shpenzimeve të tilla si eliminimin e xhamit, të letrës, të vendit ku hidhen mbeturinat, etj. Ajo do t'ju faturohet një herë në vit nga administrata komunale. Kjo taksë mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Çmimi i saj do të varet nga angazhimi juaj si dhe nga përpjekjet e përbashkëta për administrimin e mbeturinave.

Disa masa përcjellëse janë dekretuar, kryesisht në favor të familjeve. Për më shume informacion mund të drejtoheni pranë administratës së komunës suaj.

### MBETURINAT URBANE

Mbeturina shtëpiake, mbeturina që zënë vend, letër, karton, xhamra, etj.  
Vendi ku hidhen mbeturinat, pika ekologjike, mbledhje mbeturinash, djegie mbeturinash,

Financuar nga

Taksa rajonale për qese

Dhe

Taksa shtesë për mbeturinat  
nën autoritetin komunal